



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 61 datë 06.09.2018

**PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË UJËSJELLËS
KANALIZIME DIBËR SH.A.**

Në mbështetje të gërmës "h", të pikës 1 të nenit 14, dhe nenit 32/1 pika a / b të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe Rregullores së Inspektimit të miratuar me vendim të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 58, datë 29.12.2017, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Dibër sh.a. dënohet me gjobë në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë për mos zbatim të tarifave të ERRU-së për tarifafat.
2. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Dibër sh.a. dënohet me gjobë në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë për mospagimin e detyrimeve financiare ndaj Entit Rregullator, brenda afateve kohore të përcaktuara nga ky institucion.
3. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit ngarkohet të njoftojë Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Dibër sh.a. për vendimin e marrë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja dijani mbi vendimin.

KRYETARI

Ndriçim Shani